

ADMIRIM DOMI

GJUHA E POLITIKËS DHE POLITIKAT GJUHËSORE

Çfarë është gjuha e politikës?

Përkufizimin më të plotë e jep shkrimtari Xhorxh Oruell, i cili thotë: “gjuha politike është ndërtuar e tillë që të bëjë gënjeshtër të tingëllojnë të vërteta dhe vdekjen të respektueshme”¹. Në mbështetje të këtij përkufizimi vjen edhe shkrimtari dhe kritiku letrar Umberto Eko². Ai thotë: “Një politikan gënjeshtar është jashtëzakonisht i ndryshëm nga të gjithë gënjeshtarët e tjerë. Gjenialiteti i këtij njeriu qëndron vetëm në faktin se ai ka një pasuri të pashtershme në formulimin e gënjeshtërave politike, të cilat i shpërndan me bujari të madhe sa herë që flet, dhe që me po atë bujari, i kundërshton ato vetëm një orë më pas. Prandaj, nëse mendoni ta analizoni dhe ta interpretoni atë që ai thotë, duhet të imagjinoni krejt të kundërtën, nëse nuk doni të mbeteni të zhgënjyer.”

Autorët amerikanë Robert Denton dhe Geri Uduort³ e karakterizojnë komunikimin politik si një mënyrë e qëllimtë e dërguesit për të ndikuar në mjedisin politik. Ata thonë: “faktori themelor që e bën një komunikim politik”, nuk është burimi i mesazhit, por përmbajtja dhe qëllimi i tij”. Një autor tjetër, Brajan MekNeir⁴, jep një përkufizim të ngjashëm, kur shprehet se komunikimi politik është: “komunikim i qëllimtë rreth politikës”.

Babai i gjuhësisë gjenerativiste, Naom Chomsky, përveç se ka botuar një libër të titulluar “Gjuha e Politikës”⁵, ka shkruar edhe më tej, duke na zbuluar dhjetë strategji me të cilat nëpërmjet masmedias, shteti kontrollon shoqërinë⁶. E gjitha kjo bëhet nëpërmjet gjuhës së politikës. Për të mos u zgjatur më tepër do të them se: politika është art i fjalës, por në Shqipëri këtë art e praktikojnë, shumë pak artist.

Gjuha e politikës dhe shqipja standarde.

Mjafton të dëgjosh ligjërimin e një politikani dhe kupton se sa pak punojnë ata me gjuhën dhe sa pak rëndësi i kushtojnë asaj. Gjuha e politikës është e mbushur me fjalë të huaja, ç’ka e bën atë të pakuptimtë, në veshët e

¹ George Oruell, *Politics and the English Language*, 1946 [L.m./F.s.: 2004-07-24 / 39.75 KiB]

² Umberto Eco “Il costume di casa”, bypass shou 18.2.2014.

³ R.E. Denton, G.C. Woodward, *Political Communication in America*, New York: Praeger, 1998, p.11.

⁴ B. McNair, *An Introduction to Political Communication*, London: Routledge, 2003, p. 24.

⁵ Naom Chomsky, *Language and Politics*.

⁶ Naom Chomsky “Media control”/ bypass shou 29.4.2013.

publikut. Në faqet e një të përditshme gjeta këtë reagim për gjuhën e politikanëve: *“Nuk e kuptoj fare fjalorin e udhëheqësve tanë, nuk e di ku i kanë marrë këto fjalë ata. Fizibilitetin, për shembull, që nuk e kam kuptuar dhe nuk kam arritur ta kuptoj deri tani. Këtë fjalë e kemi shndërruar në humor, çka mendon për fizibilitetin, nuk të përgjigjet askush, se nuk e dinë së çfarë është”*⁷.

Fjalët e huaja nuk janë problem i vetëm i gjuhës së politikës, pasi shqetësim më i madh është kur ata flasin shqip. Në një raportim të një organizate jofitimprurëse, e cila monitoron Kuvendin e Shqipërisë, në sezonin parlamentar 2009-2013, rezultoni plot 18 raste të shkeljes së etikës parlamentare⁸. Ndërsa në një monitorim gati 8 vjeçar që emisioni “bypass shou” i ka bërë gjuhës së politikës, që është përdorur jo vetëm në sallën e kuvendit, por edhe jashtë saj, rastet e shkeljes së etikës dhe përdorimit të një gjuhe jo të përshtatshme janë edhe më të shumtë. Po jua sjell në mënyrë të përmbledhur disa prej këtyre rasteve.

ti je një plak i rrjedhur; po jot motër që sh...moteleve...;hej a mbush ti...;do i shkul dhëmbët dhe dhëmballët aleancës punisto mafioze...;do të thonë o kryeministër rrotë avioni...;ta bëj fytyrën si këpuca...;të ndërkohoj në mënyrë ekzemplare nga fëmijëria jote deri më sot...;ta mbyll gojën në mënyrën më ekzemplare...;kapeni, jashtë për zhelesh, vagabond...;kualicioni i qelbësirave...;ti do të varesh tek ato palmat atje...;lavire dhe horr bulevardit...;ai është një zhuls...;vrina e fundit e kavallit...;vrina që vetëm vjedh...;nuk po merrem me topat që i varen anash opozitës...;po ua kalëron nanat...;more, je i pirë...;hyzmeqar je ti;do kishin bërë mirë të të kishin rrahur...;kungull mos të mbiftë fara, nga do shkoj me del përpara...;lakuriq me gjethe fiku...;ti je det, det i gjërë...;kur nuk çante, me nder jush, kolektorin;po ç'pika që s'të bie more; ...kur të shk...mamaja ...nuk ka asnjë burrë nëne dhe asnjë bir k...; ta tregoi un nga ç'a kam frikë; mos u mërzi...;të pres kur të dalësh tek dera; me kë tallesh ti...; je tredhur që në rininë tëndë...; edhe ju i thoni lepurush kryetarit...; mbylle gojën shkë...mbylle gojën kokërrjepur...e dëgjove ti mi ej...; kur dush e si dush; ...pirdh, pirdh se lirohesh...; mos e çani atë fare...;

asfalt, çar asfalti...çar ti them un atij, s'di ç'ti them...; është larguar me rroba grash...me rroba grash është veshur...;del këtu si horri lakuriq...;bordello...; historian i leshit...;dordolec...; pusho ti, o mi halesh...; këtu duhet të vijë ai kryekriminel, ai bastard, ai hajdut, ai vagabond; nuk ka psiqiatër që e kuron...; përjargej...; ...që nxirrte tym nga prapa...; je bërë synet politik...;sali efendi, unë nuk e dija që je marr me synete, e dija që je

⁷ Luljeta Krasniqi –Veseli/ “Fjalori i politikanëve i pakuptueshëm nga të rinjtë” <http://www.evropaelire.org/content/article/24738849.html>

⁸ Raporti unëvotoj për periudhën shtator 2009- maj 2013 / <http://www.unevotoj.org/>

marrë me zemrën...; efendem...unë thashë synet politik, se për atë tjetrin dihet...; jeni amator të pilafit...; jeni pilafdashës të njohur botërisht...; ne nuk hipim në tavolinat, apo karrigat e ministrave, siç keni bërë ju jo shumë larg me parë...; bëni sikur jeni rivirgjëru, por ai që keni qenë jeni përsëri...;

duhet ti japim ujë të lahet pa pague...; s'e pranonte njeri në dhomë, se qelbej në erë...; ai është një zhuls...; kur të gjente si gomar lakuriq...; ti je një analfabet...; jeni bërë si shaban qosja...;

mos përmendni më litarin në shtëpinë e të varurit, se të varurin e keni aty brenda dhe ju mban varur që të gjithëve...; atë që u kam bërë baballarëve do tu bëjë edhe të bijve...; provoje po ta mbajti...; tu tregoj sa u vlen lëkura...; kur i do saimiri kryeministrit...; nuk keni pse merrni nëpër gojë mushkat...; kush e ka kokën në vendin e gabuar, është e sigurtë që drejtohet jo nga koka, por nga një vend i gabuar...; po ty s'të punon o burrë, kudo që me shku.⁹

Përdorimi i një gjuhe jo të përshtatshme, fyese, kërcënuese dhe denigruese është bërë një fenomen i rëndomtë dhe i shpeshtë në politikën shqiptare. Po, ku e ka zanafillën kjo gjuhë politike me këtë fjalor kaq të rënduar dhe vulgar? Në një shkrim tijin, Artan Fuga përgjigjet¹⁰:

"Ky lloj fjalori hyri në Shqipëri qysh në fillimin e viteve nëntëdhjetë. Është fjalori ku aktorët politikë përdorin kryesisht metafora gjuhësore të marra nga gjuha e përdorur mes prokurorit dhe fajtorit, kriminelit."

Një problem një tjetër që ndeshet shpesh në gjuhën e politikës, është drejtshqiptimi dhe dialektizimi i gjuhës. Ka politikan që pa përfunduar ende fjalinë kalojnë tek tjetra, siç ka edhe shumë të tjerë që kanë problem me shqiptimin e drejtë të fjalëve. Janë të shumtë politikanët që keqpërdorin format e paskajores, kështu: në vend të *shkuar*, përdoret *shku*, ose *shkue*; në vend të *dëgjo* apo *dëgjuar*, përdoret *digjue*: Problem është edhe përdorimi i përemrit çfarë; Në shumë raste ai del në formën çar, ose ça si p.sh.: *ta tregoi un nga ç'a kam frikë, asfalt, çar asfalti...çar ti them un atij*.

Avni Mustafa, gjuhëtar nga Maqedonia e përkufizon në këtë mënyrë këtë prirje të gjuhës së politikanëve: *"As ligji, as dëshira jonë, nuk e rregullon këtë çështje. Janë këtu një mori faktorësh që kanë ndikuar për përdorimin e tillë të gjuhës në opinion nga figurat politike të vendit. Nuk ke si i'a zë për të madhe një politikani i cili tërë jetën e ka kaluar në shkollën e fshatit të tij dhe fjalori e kultura gjuhësore e tij shtrihen aq sa mund të kapë një shtresë e tillë e komunikimit gjuhësor, si që nuk mund t'i zihet për të madhe një politikani i cili*

⁹ Karakteristika të ligjërimit politik në Shqipëri/ <http://al.ejo-online.eu/1200/politika-e-medias/karakteristika-te-ligjerimit-politik-ne-shqiperi>

¹⁰ Artan Fuga "Ku po shkon gjuha politike"/ www.albeu.com/.../ku-po-shkon-gjuha-politike/25807

gjithë shkollimin e tij e ka bërë maqedonisht, ashtu që tash edhe kur flet shqip, i formulon fjalitë më logjikë e me sintaksë të maqedonishtes”¹¹

Qemal Murati, thotë se kjo dukuri nuk vërehet vetëm tek politikanët por gjithkund duke mos përjashtuar edhe mediat: *“Ne sot kemi gjuhë të politikanëve, një gjuhë të thatë, të pa shkathët, pa gjak, të varfër, me konstrukte sintaksore të panatyrshme për gjuhën shqipe që varfërojnë gjuhën shqipe, të mbushur me fjalë të huaja.”¹²*

Problem tjetër i hasur në gjuhën e politikanëve është shmangia e vetëdijshme nga norma.

“Unë flas gjuhën e Fishtës”, kështu u përgjigj një politikane shqiptare, kur dikush i vuri në dukje se po përdorte një gjuhë jo korrekte në sallën e kuvendit. Askush nuk mund t’i mohojë të drejtën një politikani, për të folur gjuhën e Fishtës, Mjedës, Nolit, Konicës, Naimit apo cilësdo figure të shquar të letrave shqipe, por këtë nuk mund ta bëjë në sallën e kuvendit. Shqipëria është një Republikë Parlamentare dhe e ka të përcaktuar në Kushtetutë, në një nen të veçantë, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe gjuhës kombëtare. Një pyetje tjetër që duhet të ngre është: çfarë do t’i ndalonte politikanët që ta përdornin këtë gjuhë?

Politikat gjuhësore.

Në një intervistë të dhënë për një të përditshme shqiptare profesoreshë Kristina Jorgaqi shprehet:

“Duhet hartuar një strategji për të marrë në dorë punët e gjuhës, ku gjëja e parë është miratimi sa më shpejt nga parlamenti i një dokumenti që shpall politikën gjuhësore afatgjatë të shtetit shqiptar. Asnjë gjuhë standarde nuk mund të funksionojë me efikasitet dhe t’u shërbejë siç duhet përdoruesve të saj, nëse shteti nuk përpunon dhe zbaton një politikë gjuhësore me pikësynime të qarta. Gjëja e dytë është hartimi dhe miratimi i një ligji gjuhësor. Një ligj i tillë, veç tjerash, është edhe një mjet për ta konkretizuar e realizuar një politikë gjuhësore të shpallur tashmë. Gjëja e tretë është ngritja e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e ligjit dhe realizimin e detyrimeve që vijnë prej miratimit të tij.”

Zgjidhja është tek një ligj për gjuhën. Ideja nuk është e re dhe është përfolur edhe më parë nga gjuhëtar të tjerë. Jam pro, hartimit të një politike gjuhësore, por të presësh që këtë politikë gjuhësore, ta bëjë politika, është njëlloj si t’i lejosh një alkoolisti, të bëjë një ligj kundër alkoolit. Por kush mund ta udhëheqë këtë politikë gjuhësore?

Shekspiri thotë: “Ku ka dëshirë / për të bërë diçka, gjendet edhe rruga”

¹¹ Driton Dikena “Gjuha e politikanëve kaç e fug”/ <http://www.vllpress.com/1416/gjuha-e-politikaneve-kac-e-fug->

¹² “Shqipja ka nevojë urgjente për një politikë gjuhësore” www.balkanweb.com/.../shqipja-ka-nevoje-emergjente...

Për pastrimin e gjuhës nuk mund të mbështetemi as tek politika dhe as tek media, sepse ne nuk e kemi ende kulturën e pastrimit të gjërave që ndotim vetë. Mundësia më e mirë është që të kërkojmë ndërhyrjen e ushtrisë. Nëse ushtria nuk ja del dot të pastrojë gjuhën shqipe nga mbeturinat siç bëri me akset rrugore, atëherë duhet menduar një zgjidhje tjetër.

Gjatë gjithë këtyre viteve që punoj në fushën e medias dhe monitoroj gjuhën e politikës, kam vënë re se kur flasin një gjuhë të huaj, politikanët tanë janë shumë më të kujdesshëm, sesa kur flasin gjuhën e tyre. Kam dëgjuar se ato kanë ofruar mbështetjen e tyre për gjuhët e dyta dhe nuk kanë thënë as edhe një fjalë për gjuhën e parë. Shqipëria është e mbushur me qendra gjuhësh, që të mësojnë anglisht, italisht, gjermanisht e deri kinezisht, por nuk ka as edhe një qendër të vetme që të mësojë shqip. Duke parë gjithë këtë pasion që kemi për gjuhët e huaja, a nuk do të ishte më e udhës që të shpallnim gjuhë të parë anglishten, ose kinezishten dhe shqipen ta shpallim gjuhë të dytë. Duke u përdorur më pak, ajo do të ndotej edhe më pak.

